

TERMAT E REFERENCES _" TeR"

I. HYRJE

Bazuar në Ligjinnr.9130 dt. 08.09.2003, "Per Autoritetin Portual", neni 1, e ne zbatim te tij, **me qëllim** ;

- Realizimin e objektivave tregtarë konkurruese ne Portin e Durrësit,
- Zhvillimin ekonomik te tij përmes investimeve të drejtpërdrejta nga sektori privat dhe zvogëluar në këtë mënyre shpenzimet publike.
- Shndrimin gradual të Portit të Durrësit nga "Port shërbimi", në "Port Administrues i Trojeve",
- Rritjen e pavarësisë tregtare të tij,

Autoriteti Portual Durrë, synon të realizojë që; Me anë të një Kontrate Sherbimi, të menaxhojë të gjitha shërbimet e lidhura me ngarkimin dhe shkarkimin e automjeteve per import –export.

SHERBIMI I NGARKIM-SHKARKIMIT

1 Në rastin e shkarkimit të kontenierve, shërbimi përfshin,

- Lëvizja e konteinerit nga pika e ngarkimit në zonen Terminalit Kontenier ,drejte zones se caktuar në sheshin e portit (Terminalit të Autove)
- Shkarkimin e konteinerit nën drejtimin e komandës së supervizorit te terminalit te autove nga kamjoni , në pikën e shkarkimit në sheshin e autove ne port.
- Dërgimi (ngarkimi) i konteinerit nga pika e shkarkimit në zonën (TA) e caktuar të sheshit të portit (terminalit), në pikën e ngarkimit ne Sheshin e Terminalit Kontenier.
- Shkarkimin e makinave me lefterak qe ndodhen brenda ne Kontenier ne sheshin e autove
- Kontrollin dhe regjistrimin e numrit të konteinerit;
- Regjistrimin e makinave qe ndodhen ne konteinerit me ane te numrit te shasisw te cilat do te nxirren në Shesh Terminalin e Autove
- Zhvendosien e makinave me lefterak sipas urdher pageses se doganes referuar pozicionit ne shesh

2 Në rastin e ngarkimit të kontenierit, shërbimi përfshin:

- Ngarkimit automjeti sipasei dërguesit, në zonën terminalit te autove dhe lëvizjen e tij me lefterak në kontenirin e caktuar për ne terminalit e kontenierve ;

- Ngarkimi i konteinerit në trajler, nën drejtimin e komandës së supervisorit të terminalit të autove , në përputhje me planin e komandës së anijes për stivimin e ngarkesës.
- Lëvizja e konteinerit nga pika e depozitimit (në terminalin e autove) për në pikën e ngarkimit (Ne zonen e terminalit kontenier);
- Kontrollin dhe regjistrimin e numrit të konteinerit dhe nr te makinave(Nr.Shasie);

Operatori ekonomik që do të realizojë shërbimet e ngarkimit/shkarkimit të mjeteve në zonen e operimit të terminalit të autove në Portin e Durrësit do të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për lëvizjen e mjeteve që nuk kanë përfunduar procedurat doganore për spostimet e tyre sipas kërkesës dhe nën drejtimin e komandës së supervisorit të terminalit të autove.

4. Pasqyra përmbledhëse e Raportit Mujor, do të jetë e shoqëruar nga një raport i cili do të paraqesë ;

a) Një analizë të detajuar të ngarkimeve dhe shkarkimeve që janë kryer gjatë periudhës mujore.

Nr	Nr/ Kontenieri	Data e kalimit të Kontenierit në zonen e Autove	BL e Kontenierit	Lloji i Mjetit	Nr.Shasise
1					
2					
3					
4					
5					
6					
7					
8					
9					
10					
11					
12					
TOTALI					

Nr	Nr/ Kontenieri	Data e kalimit të Kontenierit në zonen e Terminalit Kontenier	BL e Kontenierit	Lloji i Mjetit	Nr.Shasise
1					
2					
3					
4					
5					
6					
7					
8					
9					
10					
11					
12					
TOTALI					

b) Propozime të mundëshme për përmirësim,

c) Raport i Historikut të shërbimit Ngarkim/Shkarkim dhe Transport për seicilin muaji.

5. Pasqyra përmbledhëse për pagese Mujor,

NR	PËRSHKRIMI I SHËRBIMEVE	NJËSIA	SASIA	CMIMNJESI	VLERA	AFATI
1	Shkarkim Konteinerë 40" 45" PLOT	cp/knt				1 MUAJ
2	Shkarkim Konteinerë 40" 45" BOSH	cp/knt				1 MUAJ
3	Ngarkim Konteinerë 40" 45" PLOT	cp/knt				1 MUAJ
4	Ngarkim Konteinerë 40" 45" BOSH	cp/knt				1 MUAJ
5	Lëvizje Konteinerë 40" 45" BOSH me Mjeti TRACK	cp/knt				1 MUAJ
6	Lëvizje Konteinerë 40" 45" PLOT me Mjeti TRACK	cp/knt				1 MUAJ
7	Lëvizje Mjeti me Forklift 3.5-5 T Hyrje/Dlje nga Koontenieri	cp/Mjeti				1 MUAJ
Çmimi Neto						
TVSH (%)						
Çmimi Total						

Ne baze të tabelese se mesiperme do të kryhet pagesa e firmosur nga perfaqesuesi i Autoritetit kontraktor, të ciles do të bashkelidhet dhe dokumentacioni shoqerues për cdo mjet dhe cdo kontenier të perpunuar.

6. GJOBAT DHE ZBRITJET

Gjobat për shkak të veprimtarisë të filluara me vonesë,

Nëse operatori vonon fillimin aktual të veprimtarisë shërbimit më shumë se një ditë pas datës së njoftimit zyrtar të dhënies së kërkeses nga AK, mbi të do të vendoset një gjobë që shkon për çdo ditë në shumën tre për qind (3 %) të të drejtës së përfitimit mujor,

Gjithashtu, në këtë rast, detyrimeve të Operatorit ,do të shtohet dhe çdo shpenzim tjetër që buron nga ndërhyrjet shërbimit të kryera nga të tretët në mungesë të fillimit të veprimtarisë nga ana e tij.

Gjobat për Pakujdesi dhe mangësi,

Në rast të pakujdesisë apo mangësisë së operatorit në kryerjen e detyrimeve të tij kontraktore, lidhur me organizimin dhe menaxhimin e veprimtarisë së shërbimit, mbi të do të vendoset një gjobë në kuotën e një për qind (1%) të së drejtës së përfitimit të tij mujor për çdo rast, gjoba do të përsëritet nëse situata nuk ndreqet gjatë brenda kohës së përcaktuar nga APD-ja në njoftimin për vënien e gjobës për herën e parë.

Në rastin e ngarkimit/shkarkimit të mjeteve, shërbimi duhet të përfshijë dhe siguracionin e mjeteve të cilat do të demshperblehen në raste se demtohen gjatë operimit për ngarkim /shkarkim si dhe spostimeve sipas operacioneve që ndodhin brenda zonës së terminalit të autove.

Pagimi i gjobave,

Operatori duhet të paguajë gjobën që i është vënë atij përcaktuar, brenda dy javëve nga marja e njoftimit dhe, nëse nuk është kryer gjatë kësaj periudhe, atëherë APD, do ta mbajë atë duke e zbritur nga pagesa mujore e ardhshme e tij.

Kostot nga Shkelja e Kushteve të Kontrate,

Eshtë rënë dakort që kostot që shkaktohen nga operatori, rrjedhoje e mosplotesimit të ndonjërit nga kushtet dhe afatet e marreveshjes kuader dhe kontrataev te lidhur bazuar ne te do të jenë nën përgjegjësinë dhe do pwrballohen me shpenzimet e tij.